



**REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT**  
**AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE**

**PA1 Nr.08-192**

**16.06.2023**

**Shkup**

Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 22 dhe neni 20 paragrafi (1) nënparagrafi 10<sup>1</sup> të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.42/20, 77/21), pika 5 nga Vendimi për shpallje të konkursit publik për dhënie të lejes për transmetim në radio të shërbimit programor të Institucionit Radiodifuziv Jofitimprurës në nivel lokal, PA1 nr.08-98 datë 9.3.2023 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 55/23) dhe pika 10 të dokumentacionit të konkursit për shpallje të konkursit publik për dhënie të lejes për transmetim në radio të shërbimit programor të Institucionit Radiodifuziv Jofitimprurës, në nivel lokal, në zonën e komunës së Tetovës, PA1 nr.08 -98 datë 9.3.2023, dhe në lidhje me nenin 72, 73, 74 dhe 75 paragrafi (1) nga Ligji i njëjtë, neni 93 i Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.124/15), neni 15 paragrafi (1) nënparagrafi 19 dhe neni 39 paragrafi (1) nënparagrafi 10 të Rregullores për punë të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Tekst i pastruar) nr.01-3732/1, datë 29.7.2019, duke vepruar në bazë të Kërkesës për pjesëmarrje në konkurs publik për dhënie të lejes për linstitucionin Radiodifuziv Jofitimprurës për transmetim në radio të shërbimit programor në nivel lokal në zonën e komunës së Tetovës, parashtruar nga Universiteti i Tetovës - Republika e Maqedonisë së Veriut, Tetovë, PA1 nr. 08-192 datë 17.5.2023, dhe në pajtim me Konkluzionin ark. nr. 02-2414/3 të datës 15.6.2023, në seancën e 19-të mbajtur më 15.06.2023, miratoi si në vijim.

**V E N D I M**

**për refuzim të Kërkesës për pjesëmarrje në konkurs publik për dhënie të lejes për  
Institucionin Radiodifuziv Jofitimprurës për transmetim në radio të shërbimit  
programor në nivel lokal në zonën e komunës së Tetovës.**

**PA1 nr.08-192 datë 17.5.2023**

1. REFUZOHET Kërkesa për pjesëmarrje në konkursin publik për dhënie të lejes për Institucionin Radiodifuziv Jofitimprurës për transmetim në radio të shërbimit programor në nivel lokal në zonën e komunës së Tetovës, parashtruar nga Universiteti i Tetovës - Republika e Maqedonisë së Veriut, Tetovë, PA1 nr.08-192, datë 17.5.2023, për arsye se nuk i plotëson kushtet programore të përcaktuara në Vendimin për shpallje të konkursit publik për dhënie të lejes për transmetim në radio të shërbimit programor të Institucionit Radiodifuziv Jofitimprurës në nivel lokal, PA1 nr. 08-98, datë 9.3.2023, dhe atë:

- për shkak të gabimeve në plotësimin e dokumenteve nga aspekti programor (Koncepti i programit, Orari i programit javor dhe Përshkrimi i përmbajtjeve/emisioneve të planifikuara të programit), nuk mund të bëhet notimi, pra në Formularin për konceptin e programit aplikanti i kërkesës nuk ka treguar se sa orë të programit do të transmetohen të dielën, dhe sipas Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, radiot jofitimprurëse duhet të transmetojnë të paktën 4 orë program në ditë gjatë javës;

- të dhënat për kohëzgjatjen e programeve të paraqitura në Strukturën e programit të planifikuar javor nga Formulari i konceptit të programit ndryshojnë nga të dhënat për

---

<sup>1</sup> Paragrafët 8 dhe 9 janë fshirë , shih: Nenin 8 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele ( “ Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë ” nr. 248/18).

kohëzgjatjen e llojeve të programeve të paraqitura në Skemën e programit javor dhe në Përshkrimin e planifikuar të përmbajtjeve programore. Të dhëna të ndryshme janë evidentuar tek programet nga të tre funksionet e medias (informative, edukative dhe argëtuese); dhe

- për shkak të gabimeve në plotësimin e Formularit të konceptit programor, i njëjti nuk mund të përdoret si bazë për vlerësimet e ardhshme të zbatimit të konceptit programor në pajtim me nenin 67 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

2. Vendimi publikohet në ueb faqen e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

3. Ky Vendim është përfundimtar.

## **A r s y e t i m**

Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia) në lidhje me letrën e qëllimit për hapjen e radios nga pala e interesuar, Universiteti i Tetovës – Sektori i Kërkimeve Shkencore ( Njësia për Veprimtari Kërkimore Shkencore), Tetovë, ark.nr.02-32/1 datë 1.2.2023 (Nr.ynë ark. 08-611/1, datë 1.2.2023), Njoftimin lidhur me kërkesën informim për frekuencë të lirë për transmetim programor në radio në nivel lokal për qytetin e Tetovës nga Agjencia për Komunikime Elektronik ark.nr.0805- 449/2 datë 17.2.2023, (Nr ynë ark. 08-611/4, datë 20.2.2023) dhe Studimi për përcaktimin e arsytimit të shpalljes së konkursit publik për dhënie të lejes për radio jofitimprurëse në nivel vendor, në zonën e komunës së Tetovës, ark.nr.03- 986/1 datë 3.3.2023, në seancën e 9-të mbajtur më 3.8.2023. miratoi Vendim për shpallje të konkursit publik për dhënie të lejes për transmetim në radio të shërbimi programor Institucionit Radiodifuziv Jofitimprurës destinuar për popullatën studentore, në nivel lokal, në zonën e komunës Tetovë, PA1 nr. 08-98, datë 9.3.2023, në gjuhën shqipe dhe maqedonase, e cila do të transmetohet nëpërmjet radiofrekuencës së përcaktuar nga Agjencia për Komunikime Elektronik të RMV-së, përkatësisht: 107.2 MHz. Vendimi i cituar është publikuar në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 55/23 dhe në dy gazetat ditore : “Slloboden pečat” dhe “Koha”, më 14.3.2023. Vendimi është publikuar në ueb faqen e Agjencisë ( [www.avmu.mk](http://www.avmu.mk) ).

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve për pjesëmarrje në konkursin publik ishte deri më 15.5.2023, përkatësisht kandidatët e konkursit duhet të paraqesin kërkesë në afat prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh, duke llogaritur nga dita e parë pas publikimit të Vendimit për shpallje të konkursit publik për dhënie të lejes për transmetim në radio të shërbimi programor të Institucionit Radiodifuziv Jofitimprurës në nivel lokal në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”. Në Agjencion, më datë 17.5.2023, ka ardhur 1 (një) Aplikim nga Universiteti i Tetovës - Republika e Maqedonisë së Veriut, Tetovë, i vërtetuar me PA1 nr. 08-192, datë 17.5.2023, për pjesëmarrje në konkursin publik, dërguar më 12.5 2023, në afatin e përcaktuar ligjor, me dokumentacion shoqëruar.

Hapja publike e Aplikacionit të dorëzuar për pjesëmarrje në konkursin publik nga kandidati i lartpërmendur është mbajtur 5 (pesë) ditë pas skadimit të afatit për dorëzimin e aplikacioneve, respektivisht më datë 22.5.2023, në të cilin aplikacioni i dorëzuar është shqyrtuar nga aspekti nëse është i rregullt, në kohë dhe i plotë, respektivisht nëse i përmban të gjitha dokumentet e specifikuar në nenin 73 paragrafi (3) nga Ligji për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV). Në hapje publike, është mbajtur Procesverba nga hapja publike e aplikimit për pjesëmarrje në konkurs publik për dhënie të lejes për transmetim në radio të shërbimi programor të Institucionit Radiodifuziv Jofitimprurës në nivel lokal në zonën e Komunës së Tetovës PA1 nr.08-192 të datës 22.5.2023.

Sipas nenit 74 paragrafi (1) të LSHMAAV, Agjencia vlerëson aplikacionet në bazë të kriterëve vijuese: përfaqësimi i synuar i programit të prodhuar nga vetë transmetuesi (prodhim vëndor in-house production) dhe prodhimi i veprave audio ose audiovizuele maqedonase; kualiteti, zhanret dhe tematikat e ndryshme të përmbajtjeve, e cila do të kontribuojë në diversitet dhe pluralizëm më të madh në tregun maqedonas; përfaqësimi i programeve që nxisin zhvillimin dhe ruajtjen e kulturës kombëtare; përfaqësimi i synuar i programeve nga producentë të pavarur dhe i veprave audiovizuele evropiane; kushtet teknike për prodhimin e programeve; kushtet hapësinore për kryerjen e veprimtarisë; numrin dhe strukturën e

punonjësve të nevojshëm për kryerjen e veprimtarisë; aftësinë financiare për të kryer veprimtarinë për kohën për të cilën është dhënë leja dhe garancitë e ofruara; afati i ofruar për fillimin e ushtrimit të veprimtarisë; dhe koha e ofruar e transmetimit ditore.

Neni 74 paragrafi (3) të LSHMAAV përcakton se Agjencia në Vendimin për shpallje të konkursit publik për dhënie të lejes për transmetim në televizion ose radio, përcakton mënyrën e pikësimit të kriterëve nga paragrafi (1) i lartpërmendur i këtij neni, me ç'rast kriteret: pritjet e përfaqësimit të programit prodhuar nga vetë transmetuesi (in-house production) dhe prodhimi i veprave audio ose audiovizuale maqedonase ), cilësia, zhanri dhe diversiteti tematik i përmbajtjeve, i cili do të kontribuojë në diversitet dhe pluralizëm më të madh në tregun maqedonas ) dhe përfaqësimi i programeve që nxisin zhvillimin dhe ruajtjen e kulturës kombëtare), duhet t'i jepet pjesa më e madhe e numrit të përgjithshëm të pikëve.

Në periudhën prej 23.5.2023 deri më 31.5.2023, nga ana e Sektorëve kompetent në Agjenci është vazhduar me vlerësimin e aplikimit të paraqitur në fjalë pra konkursit publik, bazuar në kriteret e përcaktuara në tabelën në pikën 5 të Vendimit për shpalljen e konkursit publik për dhënie të lejes për transmetim në radio të shërbimit programor të Institucionit Radiodifuziv Jofitimprurës në nivel lokal, PA1 nr.08-98, datë 9.3.2023.

Kriteret e përcaktuara në pasqyrën tabelare në pikën 5 të Vendimit të lartpërmendur për shpalljen e konkursit publik zbatohen në atë mënyrë që: Sektori për Çështjet Programore vlerëson kriteret: përfaqësimi i pritshëm i programi të prodhuar nga vetë transmetuesi (in-house production) dhe prodhim i veprave audio maqedonase - pika 1 e tabelës, cilësia, zhanri dhe shumëllojshmëria tematike e përmbajtjeve - pika 2 e tabelës, përfaqësimi i programeve që nxisin zhvillimin dhe ruajtjen e kulturës kombëtare - pika 3 e tabelës, përfaqësimi i informacionit dhe i përmbajtjeve me rëndësi për grupin e synuar nga zona në të cilën do të transmetohet shërbimi programor gjatë javës - pika 4 e tabelës dhe koha e ofruar e transmetimit të programit ditor - pika 7 e tabelës; Sektori për Planifikim Strategjik dhe të Drejtat e Autorit vlerëson kriterin: numrin dhe strukturën e punonjësve të nevojshëm për kryerjen e veprimtarisë ( të paktën 3 punonjës, nga të cilët 2 gazetarë me ALK) - pika 5 e tabelës; Sektori për Financa dhe Logjistikë vlerëson kriterin: aftësinë financiare për të kryer aktivitetin dhe garancitë e ofruara - pika 9 e tabelës; Sektori i Mbështetjes Informatike dhe i Punëve të Përgjithshme vlerëson kriteret: kushtet teknike për prodhimin e programeve - pika 6 e tabelës, kushtet hapësinore për kryerjen e veprimtarisë - pika 8 e tabelës dhe afati i ofruar për fillimin e ushtrimit të veprimtarisë - pika 10 e tabelës.

Pas shqyrtimit të Aplikacionit dhe dokumentacionit shoqërues, Sektori i Mbështetjes Informatike dhe i Punëve të Përgjithshme ka bërë vlerësimin, duke dhënë 16 pikë, Sektori për Financa dhe Logjistikë ka dhënë 7 pikë dhe Sektori për Planifikim Strategjik dhe të Drejtat e Autorit ka dhënë 10 pikë.

Sektori për Çështje Programore, gjatë shqyrtimit të Aplikacionit në fjalë, konstatoi se edhe pse janë dorëzuar të gjitha dokumentet nga aspekti programor (koncepti i programit, skema programore javore dhe përshkrimi i përmbajtjeve/emisioneve të planifikuara programore), për shkak të gabimeve në plotësimin e tyre nuk mund të bëhet notimi, domethënë në Formularin për konceptin programor parashtuesi i kërkesës nuk ka reguar pajtim me Ligjin për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale radiot jofitimprurëse duhet të transmetojnë të paktën 4 orë program në ditë gjatë javës; të dhënat për kohëzgjatjen e programeve të paraqitura në Strukturën e programit të planifikuar javor nga Formulari i konceptit të programit ndryshojnë nga të dhënat për kohëzgjatjen e llojeve të programeve të paraqitura në Skemën e programit javor dhe në Përshkrimin e përmbajtjeve programore të planifikuara. Të dhëna të ndryshme janë evidentuar tek programet nga të tre funksionet e medias (informative, edukative dhe argëtuese) dhe për shkak të gabimeve në plotësimin e Formularit të konceptit programor, ai nuk mund të përdoret si bazë për vlerësimet e ardhshme të zbatimit të konceptit programor në pajtim me nenin 67 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Përkatësisht, në T.4 nga Formulari për konceptin programor (sa orë në ditë dhe sa orë në javë do të transmetohet programi), parashtuesi i kërkesës nuk ka reguar se sa orë program do të transmetohet të dielave, dhe sipas LSHMAAV stacionet e radiove jofitimprurëse duhet të transmetojnë të paktën 4 orë program në ditë gjatë javës. Në tabelën nga T.8 (Struktura e pjesës folëse të programit të planifikuar javor), ka disa probleme me të dhënat e shfaqura. Në funksionin informativ dhe edukativ, ka dallime në kohët e paraqitura në tabelë nga T.8 me të dhënat e paraqitura në Skemën Programore (më hollësisht,

të dhënat krahasuese, dallimet ndërmjet këtyre dy dokumenteve, jepen më poshtë, në kuadër të pikës 2). Shuma e llojeve të programeve me funksion argëtimi është e gabuar. Në fushën "Totali nga kolona 4" janë të gabuara të dhënat, e cila duhet të jenë shuma totale e kohëve të tre funksioneve, të paraqitura në kolonën e katërt. Nuk ka të dhëna në fushën (rubrikën) Segmente të tjera programore dhe sipas T.5 (Struktura e programit të planifikuar javor), është planifikuar në javë të transmetohen 2 orë segmente të tjera programore. Totali i treguar në fushën e fundit të tabelës "Totali nga kolona 3" (9 orë) është i gabuar. - Në T.5 nga Formulari (Struktura e programit të planifikuar javor), në pjesën e të folurit raportohen 9 orë ose 12% e pjesës së të folurit, ndërsa sipas të dhënave të përcaktuara në dy dokumentet e tjera, Skema programore dhe Përshkrimi i planit të përmbajtjes programore, shuma e pjesës së të folurit është gjithsej 36 orë e 35 minuta. Në T.5 nga Formulari (Struktura e programit të planifikuar javor), në rubrikën e muzikës raportohen 67 orë, pra 88%, ndërsa sipas të dhënave të deklaruara në dy dokumentet e tjera, Skema Programore dhe Përshkrimi i përmbajtjeve të planifikuara programore, shuma totale e muzikës është gjithsej 42 orë Ndërsa në T.8 të Formularit (Struktura e pjesës folëse të programit të planifikuar javor), kohëzgjatja totale e programeve me funksion informues, Lajmet, paraqitet 2 orë e 30 minuta. Shuma e lajmeve të shfaqura në gjuhën shqipe dhe maqedonase në Skemën programore është 6 orë e 25 minuta. Emisionet "Shtypi i përditshëm "(Dnevniot pečat) , "Informatori kulturor "(Kullturen informator) "Njoftimi i aktiviteteve të planifikuara (UT sot)"(Najava na predvideni aktivnosti (UT denes) dhe "Sporti "(Sport) , sipas Përshkrimit nga ana e parashtruesit, ndoshta i përkasin funksionit informativ, të cilët nuk janë planifikuar fare në Tabela e T.8 (Struktura e pjesës folëse të programit të planifikuar javor) nga Formulari i Konceptit Programior. Shuma e përgjithëshme e emisioneve të mësipërme gjatë javës arrin gjithsej 7 orë e 40 minuta. Në T.8 të Formularit (Struktura e pjesës folëse të programit javor të planifikuar), kohëzgjatja totale e programeve me funksion arsimor (edukativ) është 4 orë. Shuma e programeve arsimore të paraqitura në Skemën Programore, sipas mënyrës sesi kërkuesi i klasifikoi dhe i përshkroi në Përshkrimin e emisioneve "Fokus" dhe "Parlamenti Studentor"(Studentski parlament), është 22 orë e 30 minuta. Në T.8 të Formularit (Struktura e pjesës folëse të programit të planifikuar javor), kohëzgjatja totale e programeve me funksion argëtimi tregohet të jetë 3 orë. Në skemën e programimit dhe në Përshkrimin e emisioneve, nuk janë renditur me tituj dhe është e paqartë nëse kemi të bëjmë me blloqe këngësh apo në situata të caktuara janë projektuar emisione muzikore, të cilat nëse janë, duhet të kenë përshkrim në dokumentin përkatës.

Në bazë të gjithë kësaj që është theksuar më lartë, u vendos që Aplikimi për pjesëmarrje në konkurs publik për dhënie të lejes për Institucionin Radiodifuziv Jofitimprurës për transmetim në radio të shërbimit programor, në nivel lokal, në zonën e komunës së Tetovës, dorëzuar nga Universiteti i Tetovës - Republika e Maqedonisë së Veriut, Tetovë, PA1 nr.08-192, datë 17.5.2023, të refuzohet për faktin se nuk i plotëson kërkesat programore të përcaktuara në Vendim për shpalljen të konkursit publik për dhënie të lejes për transmetim në radio të shërbimit programor në nivel lokal, PA1 nr.08 -98, datë 9.3.2023, në pajtim me nenin 75 paragrafi (1) të LSHMAAV. Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale në seancën e 19- të mbajtur më 15.6.2023, në pajtim me Konkluzionin ark.nr. 02-2414/3 të datës 15.6.20 23 ka marrë vendim si në dispozitiv .

**Agjencia për Shërbime Mediatike  
Audio dhe Audiovizuale  
Kryetari i Këshillit,  
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

**Këshillë juridike :** Ky vendim është përfundimtar dhe kundër këtij vendimi mund të paraqitet padi për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të vendimit.